



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të kohëzgjatjes së komandimit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, aktualisht i komanduar në Ministrinë e Drejtësisë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të kohëzgjatjes së komandimit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, aktualisht i komanduar në Ministrinë e Drejtësisë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Pas trajtimit të çështjes së parë të rendit të ditës e cila u trajtua vetëm në prezencë të anëtarëve të Këshillit, mbledhja rifillon me regjistrim nëpërmjet platformës.

**Naureda Llagami:** Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 13 korrik.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkohet vendimmarrje për çështjet sipas rendit të ditës. Megjithatë kemi edhe një propozim për të shtuar në rendin e ditës, përveç çështjeve që kemi, edhe projekt-aktin që ka të bëjë me ngritjen në detyrë të gjyqtarës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të znj. {...} (në kuadrin që ne kemi parashikuar në rendin e ditës renditjen për këtë pozicion në Gjykatën e Posaçme, të shtohet edhe projekt-akti tjetër i ngritjes në detyrë). Jemi dakord që ta shtojmë në rend dite?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë shtohet në rendin e ditës.

Kalojmë pa humbur kohë në çështjet e radhës.

Po fillojmë me çështjen e parë që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së mbarimit të kohëzgjatjes së komandimit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, aktualisht i komanduar në Ministrinë e Drejtësisë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Projektvendim “Për përfundimin e procedurës së mbarimit të kohëzgjatjes së komandimit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, aktualisht i komanduar në Ministrinë e Drejtësisë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 538, datë 14.12.2023 ka vendosur ndër të tjera: “1. Komandimin e z. {...} në pozicionin e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë, për një afat prej 2 vjetësh (*lapsus, pasi është për një afat pesëvjeçar*).

Më tej, më 26.05.2023 është administruar kërkesa e re e z. {...}, i cili kërkon përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit përpara afatit dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm për arsye personale dhe të justifikuara.

Në datën 13.06.2023, z. {...} i është drejtuar sërish Këshillit. Në këtë kërkesë ai parashtron tërheqjen nga kërkesa për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit para afatit dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm.

Kemi kërkuar opinionin e Ministrisë së Drejtësisë në kohën kur zoti {...} ka paraqitur kërkesën për përfundimin para afatit të komandimit.

Në vijim Ministria e Drejtësisë ka informuar Këshillin se: “Shprehim vullnetin për vijimin e komandimit të magjistratit z. {...} në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, pasi përfundimi i kohëzgjatjes së komandimit para afatit dhe kthimi i tij në pozicionin e mëparshëm cenon funksionalitetin e strukturës së posaçme kundër korrupsionit.”

Vlerësimi i Komisionit:

Kërkesa e paraqitur nga zoti {...} është e mbështetur në nenin 41 të Kodit të Procedurave Administrative, nenin 64, nenet 90-96 si dhe në nenin 94 të Kodit të Procedurave Administrative.

Bazuar sa më sipër, referuar faktit se në rastin konkret jemi para një procedure administrative të filluar me kërkesë të subjektit, në këtë rast të magjistratit dhe në kushtet kur subjekti aktualisht është tërhequr nga kërkesa e paraqitur prej tij, për sa kohë Këshilli nuk ka disponuar me një vendim përfundimtar lidhur me këtë kërkesë, vlerësohet se në rastin konkret jemi në kushtet e deklaramit të përfundimit të procedurës administrative të nisur me kërkesë nga gjyqtari {...}.

Për sa më lart, me cilësinë e relatorit, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Përfundimin e procedurës së mbarimit të kohëzgjatjes së komandimit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, aktualisht i komanduar në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të tërheqjes së tij nga kjo kërkesë.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit, nëse nuk kemi diskutime.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të relatorit.

\* \* \*

(Pika 2 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikletë), në gjykatat administrative”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

*2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashinë.*

*3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*

*4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*

*6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).*

*7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikletë), në gjykatat administrative”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek dy projekt-aktet që kanë të bëjnë me rishpërndarjen e mjeteve të transportit.

Radhën e kaluar folëm për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, tani kemi për gjykatat administrative.

Për më shumë detaje fjalën ia japim drejtorit, z. Haxhiu!

*Xhevdet Haxhiu:* Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Siç e tha edhe Kryetarja, radhën e kaluar kaluam për miratim transferimin e mjeteve të transportit të gjykatave të shkallës së parë. Sot paraqes përpara jush relacionin për transferimin e mjeteve të transportit të gjykatave administrative të shkallëve të para, të cilat pushuan veprimtarinë e tyre si rezultat i zbatimit të hartës së re gjyqësore.

Kështu, bazuar në gjendjen teknike të mjeteve të transportit të gjykatave të cilat mbyllën veprimtarinë e tyre, struktura përgjegjëse në KLGJ (Drejtoria e Investimeve) bëri një analizë të gjendjes së tyre dhe duke vlerësuar shpërndarjen e mjeteve të transportit pranë Gjykatës Administrative Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative Shkallës së Parë Lushnjë dhe Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare të Këshillit, shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes së mjeteve të transportit, sipas pasqyrës së mëposhtme. Pasqyrën e keni përpara.

Faleminderit!

Për ndonjë pyetje.

**Naureda Llagami:** Ndonjë diskutim?

Jo! Atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të Komisionit.

\* \* \*

(Pika 3 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

8

---

**Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 13.07.2023 (Pika 3)**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>        | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ridvan Hado</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>11. Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**

**4. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**6. Valbona Bala, Eksperte (EËMI).**

**7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek projekt-akti i dytë i Komisionit që ka të bëjë me rishpërndarjen e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2023.

Sërish fjalën e ka drejtori.

*Xhevdet Haxhiu:* Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni, me ligjin për buxhetin e shtetit për vitin 2023 është miratuar buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), në shumën 4,362,600 mijë lekë, i ndarë në tre programe buxhetore.

Fondet buxhetore u detajuan në fillim me vendim të KLGJ-së në fillim të vitit buxhetor 2023, edhe në programin 03310 që konsiston në buxhetin e gjykatave të të gjitha niveleve.

Riorganizimi i gjykatave, në zbatim të hartës së re gjyqësore solli edhe ndryshime në strukturat organizative dhe organikat në fakt, të të gjitha gjykatave.

Dua të bëj me dije se nga ristrukturimi, pavarësisht se ishin ndarë në tre faza ristrukturimi, janë prekur pothuajse të gjithë gjykatat e të gjitha niveleve, përveç Gjykatës së Lartë, nga lëvizja e punonjësve, magjistratëve, ashtu edhe të administratës gjyqësore.

Në muajin maj 2023 përfundoi ristrukturimi i gjykatave të rretheve gjyqësore, të cilat nga 22 gjykata, u bënë 13 gjykata. Kjo fazë e ristrukturimit, solli ndryshime, si në strukturat organizative ashtu edhe në organikat në fakt, duke prekur jo vetëm gjykatat të rretheve gjyqësore, por edhe gjykata të tjera. Në përfundim të kësaj faze, duke qenë se ishin programuar më përpara, nuk u programua rishpërndarje e fondeve në shpenzime personeli.

Në datën 1 korrik 2023, përfundoi ristrukturimi i gjykatave administrative të shkallës së parë, njëkohësisht edhe implementimi i hartës së re gjyqësore për gjykatat e të tre niveleve. Gjykatat administrative u riorganizuan në dy gjykata administrative të shkallës së parë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Në analizën që u bë, rezultojnë disa fonde të papërdorura në gjykatat që tashmë kanë mbyllur aktivitetin e tyre, si në shpenzime korrente (në artikullin 600 “paga”, 601 “sigurime shoqërore”, 602 “shpenzime operative”, dhe 606 “transfera për individë dhe familjarë”), kemi vlerësuar që këto të transferohen fillimisht në KLGJ (03310), sipas pasqyrën 1 bashkëlidhur, me qëllim rishpërndarjen e tyre gjykatave të cilat kanë ngelur pas ristrukturimit.

Kështu, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare të KLGJ, shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti i gjykatave”, në shpenzime korrente (600, 601, 602, 606), për vitin buxhetor 2023, sipas pasqyrave nr. 1, dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij relacioni.

Faleminderit!

Në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

*Naureda Llagami:* Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord. (*Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet në audio, por e kontaktuar nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar votën e saj “dakord”. Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të siglosur.*)

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të Komisionit.

\* \* \*

(Pika 4 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toro.

**Alban Toro:** Kandidatja {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, aktualisht gjyqtare e skemës së delegimit e caktuar për një periudhë kohe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka qenë kandidate e vetme për pozicionin e hapur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021 të KLGJ-së, i cili në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira

në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka iniciuar procedurat e ngritjes në detyrë.

Për këtë kandidate janë kryer disa veprime procedurale. Ndër to është verifikuar përvoja profesionale minimale, mospasja e masës disiplinore në fuqi, mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale, dhënia e pëlqimit (ajo dhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016, si dhe verifikimin e pasurisë dhe figurës.

Me Vendimin nr. 234, datë 30.06.2022, është vendosur kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë ku ka kandiduar.

Në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional, për këtë kandidate janë administruar vendimi i Këshillit nr. 120, datë 15.03.2023, ku kandidatja është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 390 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim. Me vendimin nr. 43, datë 27.01.2023 Këshilli ka vendosur për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Dy vendimet e sipërcituara të Këshillit të Lartë Gjyqësor të kandidates znj. {...} të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 43, datë 27.01.2023 dhe nr. 120, datë 15.03.2023, u konstatuan të jenë bërë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk rezulton të jetë paraqitur ankim.

Në kushtet kur pas kryerjes së procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, për kandidaten do të duhej të vijonin edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016; 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019, relatori i është drejtuar Komisionit të Vlerësimit Etikë Profesional për të kërkuar informacione në lidhje me ecurinë e përfundimit të vlerësimeve të mundshme.

Nga Komisioni i sipërcituar relatohet ndër të tjera se: “Gjyqtarja është emëruar në detyrë në datën 21.10.2013. Lidhur me vlerësimet e kryera dhe mundësinë e kryerjes se vlerësimeve të tjera deri në momentin kur gjyqtarja ka kandiduar për ngritje në detyrë, ju informoj se gradimi i gjyqtarës ka qenë i pamundur në objekt e qëllim për t’u realizuar,

sepse në periudhën e vlerësimit 2013-2016, gjyqtarja ka pasur më pak se 1 vit kohë efektive pune për t'u vlerësuar. Prandaj Këshilli, me vendimin nr.43, datë 27.01.2023 ka vendosur për këtë periudhë përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Gjyqtarja është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2021, duke u vlerësuar në nivelin "Shkëlqyeshëm" për periudhën e vlerësimit 2017-2019 (vendimi Nr. 120/2023). Deri në momentin e kandidimit, që është data 01.04.2021, periudha e vetme që mbetet për t'u vlerësuar është ajo e vitit kalendarik 2020, por vlerësimi vetëm për këtë vit nuk mund të fillojë sepse:

- Vlerësimet normale periodike që Këshilli mund të zhvillojë janë 3 ose 5-vjeçare, në varësi të periudhës profesionale të gjyqtarit, nën ose mbi 15 vjet. Në kushtet kur gjyqtarja nuk ka plotësuar ende 10 vjet përvojë profesionale, pas vlerësimit të vitit 2017-2019, si rregull vlerësimi tjetër periodik i saj duhet të përkohet me periudhën 2020-2022, dhe si i tillë ky vlerësim nuk mund të përdoret për kandidime për ngritje në detyrë që i përkasin vitit 2021.

- Përjashtim nga rregulli i mësipërm mbi periodicitetin e vlerësimeve, Këshilli në zbatim të nenit 97 të Ligjit për Statusin dhe akteve që plotësojnë skemën e vlerësimit të gjyqtarëve, fillon për të gjithë gjyqtarët që kandidojnë për ngritje në detyrë ose lëvizje paralele, vlerësim të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik, vetëm në rast se kanë kaluar 2 vjet nga vlerësimi i fundit. Duke konsideruar datën e kandidimit të gjyqtares, që është data 01.04.2021, vlerësim i përshpejtuar për të, nëse do të fillonte një i tillë, përkon me periudhën e vlerësimit që përfshin vitin kalendarik 2020. Por në këtë rast nuk kanë kaluar 2 vjet nga vlerësimi i fundit i gjyqtares sepse ajo është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019 dhe viti 2020 është viti kalendarik pasardhës vitit 2019. Pra për këtë gjyqtare, duke konsideruar datën e kandidimit të saj për ngritje në detyrë datën 01.04.2021, nuk mund të fillojë një vlerësim tjetër i përshpejtuar për vitin 2020, prandaj dhe Komisioni nuk ka sjellë në plenare një propozim të tillë.

Si përfundim Komisioni vlerëson se për gjyqtaren {...} nuk mund të kryhet vlerësim i përshpejtuar për vitin 2020, por ky vit duhet të konsiderohet në periudhën e mëpasshme të vlerësimit 3-vjeçare 2020-2022...".



Përfundimisht përpara relatorit shtrohet për zgjidhje çështja: Nëse në përputhje me pikën 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016, a mund të bëhet renditja e kandidatit që përmbush kriteret kualifikuese, por disponon vetëm një vlerësim, (në rastin konkret atë për periudhën e vlerësimit 2017-2019).

Në interpretim të dispozitës ligjore parashikuar nga neni 48 i Ligjit nr. 96/2016, procedura e ngritjes në detyrë bazohet në parimet e transparencës, barazisë, aftësisë dhe përvojës profesionale. Fillimisht kandidati do të duhet të plotësojë kriteret ligjore mos disponimi i së cilave e s'kualifikon detyrimisht atë nga vijimi i mëtejshëm i procedurës. Siç janë cituar më lart kriteret me natyrë skualifikuese janë ato të parashikuara fillimisht ato në nenin 162, pika 7 të Ligjit për Statusin si edhe në neni 57, pika 11, i Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të cilat kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, dhe ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të funksionarëve të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë", si edhe në pikën 3 të nenit 8, në shkronjën “b” të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 (të cilat janë cituar më pas dhe nuk po shpenzoj kohë për t'i ricituar).

Me plotësimin e kriterëve të sipërcituara të natyrës skualifikuese, ligji, qëllimi i të cilit është vendosja e standardeve për mënyrën e vlerësimit e kandidatëve për plotësimin e vendeve vakante përmes procedurës së ngritjes në detyrë, duke u bazuar në parimin e barazisë, në meritën profesionale, të transparencës dhe objektivitetit në vlerësim, nuk ka vlerësuar krijimin e ndalimeve të tjera penguese në konkurrim.

Vlerësimi i kandidatit, në përputhje me kriteret cilësore (kualitativ) e sasiore konvertuar me vlerësimin maksimal apo pikët më të larta të përlllogaritura sipas pikës 9 dhe 14 të nenit 48 të ligjit, e identifikon atë si më të mirin në atë procedurë të përzgjedhjes dhe të përshtatshëm për pozicionin e lirë. Në këtë kontekst kriteri i pasjes së dy vlerësimeve merr vlerë në një procedurë konkurrimi për të përzgjedhur më të mirin duke pasqyruar në këtë mënyrë efektin e saj plotësues/komplementar me qëllim arritjen e një sistemi gjyqësore e një cilësie më të lartë të mundshëm. Duke iu kthyer çështjes “de qua” kryerja e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatin në këtë rast, përveç se përbën një detyrim ligjor të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ajo nuk duhet të rendojë mbi kandidatin në kushtet e mungesës së plotë të konkurrencës në atë pozicion.

Kalimi i procesit të rivlerësimit me sukses nga ana e saj referuar përcaktimit të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 59, të Ligjit nr.84/2016, prezumon se kandidatja ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, pra se ajo është vlerësuar “E aftë”, pra që ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, si dhe se ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme përgjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar, sikurse një gjë e tillë përcaktohet në shkronjën “a”, të nenit 44, të këtij ligji.

Vlerësimi në nivelin e përgjithshëm “i pamjaftueshëm”, pra një vlerësimi etik dhe profesional me cilësi të dobët, jo vetëm nuk do të përlligjte ngritjen në detyrë, por, përkundrazi, referuar pikës 6, të nenit 95, të Ligjit për Statusin, do të përbënte shkas për dërgimin e raportit të vlerësimit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar fillimin e hetimit dhe, më tej, të procedimit disiplinor ndaj kandidatit, duke vënë kështu në diskutim nga ana tjetër, plotësimin e kriterëve të kandidimit prej tij dhe ndalimin në konkurrim.

Në Opinionin 17 (2014), CCJE-ja, pjesë të së cilës janë integruar edhe në legjislacionin tonë, ka mbështetur pikëpamjen se prania e një lloji vlerësimi është e nevojshme dhe se standardet objektive nuk kërkohen vetëm për të përjashtuar ndikimin politik, por edhe për të shmangur rrezikun e përshtypjes së mundshme se ka favorizim, e cila është e pranishme nëse emërimet/vlerësimet bëhen në mënyrë të pastrukturuar, ose mbështetur në rekomandimet. Këto standarde objektive duhet të mbështeten në merita, duke marrë parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe eficientësinë dhe duke shqyrtuar të gjitha aspektet të përbëjnë performancë të mirë gjyqësore.

Disponimi i vlerësimit për periudhën 2017-2019, nivelin "shkëlqyeshëm", kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar, mungesa e konkurimit në këtë pozicion të lirë e për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kriterëve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të vendimit 70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Në këtë përfundim relatori ka arritur përmes vlerësimit të interpretimit që i bëhet tekstit të shkruar të normës, ligjit nr.96/2016, (interpretim gramatikor), kontekstit të saj (interpretim sistematik), synimit të normës (interpretim teologjik).

Në përfundim, nga ana e relatorit është përgatitur projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim mbi çka propozohet?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

6.1 “Për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}”.

6.2 “Për ricaktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                    |                   |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare)        |
| 2. Ilir Rusi       | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar)          |
| 4. Fatmira Luli    | (anëtare)         |
| 5. Irena Plaku     | (anëtare)         |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar)          |
| 7. Ridvan Hado     | (anëtar)          |
| 8. Alban Toro      | (anëtar)          |
| 9. Marçela Shehu   | (anëtare)         |

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

6.1 “Për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}”.

6.2 “Për ricaktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}. Për më shumë detaje, fjalën e ka zoti Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit!

Më datë 21.05.2022, gjyqtari {...} ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor formularin e kandidimit për pjesëmarrjen në skemën e delegimit, nëpërmjet të cilit ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Mbi këtë kërkesë, pasi konstatoi se gjyqtari z. {...} plotësonte kriteret për caktimin në skemën e delegimit të ngritur pranë tij, sipas nenit 45 i Ligjit nr. 96/2016

22

“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 22 datë 07.02.2019, “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarës”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 259, datë 15.07.2022, vendosi:

“1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}.

2. Caktimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.”

Si gjyqtar i skemës së delegimit, për shkak të situatës në Gjykatën Administrative të Apelit dhe nevojave emergjente të saj në lidhje me funksionalitetin, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 260/2022, z. {...} e ka caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për një periudhë të caktimit në skemën e delegimit, pra deri më datë 18.07.2023.

Afati i caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit {...}, përfundon më datë 18.07.2023, bazuar edhe në kërkesën e vetë gjyqtarit, protokolluar në Këshill më datë 29.06.2023, me anë të cilës kërkon zgjatjen e afatit të komandimit si gjyqtar, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Në këtë rast se vlerësojmë se është rasti për zgjatjen e këtij afati.

Ndodhur në këto kushte, ndërsa më herët është verifikuar plotësimi nga z. {...} të kriterëve të skemës së delegimit, duke mbajtur në konsideratë se ai ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit, sikundër dhe faktin se ligji lejon shërbimin në këtë skemë deri në 5 vjet, ndërkohë që z. {...} ka konsumuar vetëm një vit nga kjo periudhë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se është vendi për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}. Në relacion kemi thënë “edhe për një vit tjetër”, por jemi të hapur për ta diskutuar afatin nëse duhet 1 vit ose më tepër sesa një vit.

E kam thënë në relacion të shënuar dhe jemi të hapur për ta diskutuar edhe këtë pjesën tjetër.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Pika 1 e projektvendimi bën fjalë për zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}. Në relacion e kemi thënë “deri më datë 18.07.2024”, por në

këtë rast, nëse unë marr pëlqimin e të gjithë kolegëve, propozoj që mund ta zgjasim këtë afat, mund ta çojmë deri në 18.07.2026, referuar nevojave.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim?

Jemi dakord me propozimin dhe me projekt-aktin e sjellë nga Komisioni, dhe me propozimin për zgjatjen e afatit nga një në tre vjet?

**Illir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...} deri më datë 18.07.2026, afat që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 18.07.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti tjetër.



**Klodian Kurushi:** Relacioni i radhës është për ricaktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në supozimin e miratimit të projektvendimit i cili u miratua tashmë mbi zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit edhe projektvendimin “Për ricaktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Lidhur me këtë të fundit, si shkak për propozimin e këtij projektvendimi është situata në të cilën gjendet Gjykata Administrative e Apelit, e cila aktualisht është në kufijtë minimal të funksionalitetit, ndërsa pranë saj ushtrojnë detyrën vetëm 7 gjyqtarë (nga 13 sipas organikës), përfshirë këtu edhe z. {...}, i cila është gjyqtar i skemës së delegimit. Vetëm 6 (gjashtë) prej organikës së kësaj gjykate kanë emërim përfundimtar në Gjykatën e Apelit Administrativ. Pozicionet të lira në mënyrë të përhershme janë 5 dhe 2 janë vakanca të përkohshme.

Në një situatë të tillë, Gjykata Administrative e Apelit vijon të jetë në nevojë për pasjen në vijimësi në detyrë pranë saj edhe të gjyqtarëve të tjerë, çka do të mundësonte gjykimin e çështjeve të regjistruara përpara saj, referuar edhe numrit të konsiderueshëm të çështjeve që ajo ka në shqyrtim.

Kemi marrë informacionin që lidhet me tremujorin e parë të vitit 2023 lidhur me ngarkesën e dosjeve që ka secili gjyqtar që aktualisht ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit. Është bashkëlidhur kjo ngarkesë në relacion. Nuk po ndalem për të cituar një nga një ngarkesën e secilit gjyqtar.

Duke vijuar më tej, vlen të theksohet se sikurse edhe më parë është verifikuar nga Këshilli, gjyqtari z. {...} ka përvojë profesionale minimale që kërkon ligji, neni 47, pika 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndodhur në këto kushte, ne si Komision i propozojmë Këshillit projektvendimin përkatës i cili është strukturuar në katër pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} ricaktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për periudhën (në relacion dhe në projektvendim është deri më datë 18.07.2024), për sa kohë e kemi futur në skemë dhe kemi miratuar me vendimin e mëparshëm “deri në tre vjet”, atëherë propozojmë që në këtë rast afati i ricaktimit të jetë deri në datën 18.07.2026. Nëse edhe

kolegët janë dakord. Po bëjmë një propozim të ri brenda relacionit që kemi dërguar në Këshill.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e efekteve juridike të vendimit, pikërisht nga data 18.07.2022 (*lapsus viti, pasi duhet 2023*), duke pasur parasysh se në këtë datë përfundojnë efektet e vendimit të caktimit të z. {...}, si gjyqtar i skemës së delegimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, pra të Vendimit të Këshillit nr. 260 datë 15.07.2022.

Në pikën 3 të projektvendimit, sikurse edhe në vendimin e mëparshëm të caktimit, përcaktohet se efektet financiare sipas këtij vendimi të përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (pas riorganizimit të hartës së re gjyqësore (ishte Gjykata administrative e shkallës së parë Korçë). Edhe në këtë rast, përcaktimi i këtij rregullimi merr në konsideratë faktin se kjo gjykatë ka buxhetin për të përballuar efektet financiare të vendimit, ndërsa vijon të ketë pozicione të lira të përhershme.

Ndërsa në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit, z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si edhe Gjykatës Administrative të Apelit.

Së fundi në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi menjëherë dhe publikimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga relatori.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} ricaktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 18.07.2026.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 18.07.2023.

3. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, si dhe Gjykatës Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

7.1 “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”.

7.2 “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

7.1 “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. {...}”.

7.2 “Për caktimin e gjyqtarës së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. {...}. Për më shumë detaje, sërish e ka fjalën zoti Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit!

Më datën 07.07.2023 është administruar në Këshill kërkesa e Gjykatës Administrative të Apelit protokolluar me aktin nr. 3844 “Kërkesë për caktim gjyqtarësh nga skema e delegimit”.

Lidhur më këtë kërkesë të gjykatës përkatëse nga ana e anëtarëve të Komisioni ka

pasur opinione që thirrja publike për skemën e delegimit të ripërsëritet për të gjithë gjyqtarët e republikës.

Më tej, më datë 10.07.2022 (*lapsus viti, duhet 2023*), duke iu referuar fakteve, gjyqtarja Elda Vrioni (*lapsus, pasi bëhet fjalë për znj. {...}*) ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor formularin e kandidimit për pjesëmarrjen në skemën e delegimit, nëpërmjet të cilit ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Shprehja e interesit për të shërbyer në skemën e delegimit është bërë sipas njoftimit publik të Këshillit të shpallur në faqen zyrtare të internetit (është vendosur edhe adresa elektronike përkatëse).

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, konstatohet se gjyqtarja znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 30.06.2004; ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2007 si dhe ka përfunduar Master në Shkenca Penale në Universitetin e Tiranës në vitin 2008.

Me dekretin nr. {...}, datë 04.10.2006 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. {...}, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me dekretin nr. {...}, datë 16.07.2013 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, datë 10.03.2022 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Më datë 11.07.2023 ka dhënë dorëheqjen nga ky funksion.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 16 vite.

Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Vlerësimi i Komisionit:

Neni 45 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullon institutin e skemës së delegimit,

kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga magjistrati për t'u pranuar në këtë skemë, si dhe detyrimin e Këshillit për të miratuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit, duke parashikuar ndër të tjera se:

“1. Magistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t'u caktuar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill.

2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet.

3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t'u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori.”

Në zbatim të nenit 45 të Ligjit 96/2016 të sipërcituar, Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 22 datë 07.02.2019, ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”. Konkretisht, neni 4 i kësaj Rregulloreje parashikon kriteret e kandidimit në skemën e delegimit, si vijon:

“Në skemën e delegimit kandidon çdo gjyqtar që plotëson këto kriteret:

- a. Të ketë dhënë pëlqimin për t'u komanduar në skemën e delegimit;
- b. Të ketë jo më pak se 1 vit përvojë në funksion;
- c. Të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore;
- d. Të mos ushtrojë funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit;
- e. Të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e tij;
- f. Të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim”.

Bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në lidhje me parashikimet e Vendimit nr. 22/2019, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtarës {...} në skemën e delegimit, pra të caktimit të saj në këtë skemë pasi plotësohen të gjitha kriteret e parashikuara si nga neni 45, ashtu edhe nga pika 4 e vendimit nr. 22/2019 të KLGJ-së.

Sa më sipër, konkludohet se znj. {...} plotëson kriteret për t'u caktuar në skemën e delegimit.

Lidhur me efektet juridike të vendimit sa i përket vijimit të çështjeve gjyqësore.

Nga informacion i ardhur në rrugë elektronike nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë rezulton se: “Aktualisht Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është në gjendje funksionaliteti të plotë. Referuar vendimit nr.271, datë 25.05.2023 për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar”, i ndryshuar prej datës 01.07.2023 ushtrojnë efektivisht detyrën 19 gjyqtarë nga 11 gjyqtarë që ushtronin detyrën më herët në këtë gjykatë. Gjyqtarët e kësaj Gjykate në pjesën dërmuese të tyre kanë kaluar me sukses procesin e vetingut. Referuar riorganizimit të veprimtarisë së gjykatës janë marrë masa për balancimin e ngarkesës mes gjyqtarëve të cilët i janë bashkuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ne kemi pritshmëritë që funksionaliteti i kësaj gjykate të arrijë së shpejti nivele maksimale referuar balancimit të ngarkesës së gjyqtarëve, trajtimit të çështjeve të prapambetura me përparësi. Po kështu këto pritshmëri mbështeten dhe në faktin se nga ana Këshillit të Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 256, 257, datë 24.05.2023, është vendosur hapja e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për 3 (tre) pozicione të lira të përhershme.

Në lidhje me numrin e çështjeve në gjykim Ju bëj me dije se ngarkesa është si më poshtë vijon:

Gjyqtare Elda Vrioni ka 183 çështje dhe kërkesa administrative në gjykim.

Gjyqtare {...} ka 109 çështje dhe kërkesa administrative në gjykim.”

Nga informacioni i marrë pranë Drejtorisë Juridike, nuk rezulton që kjo gjyqtare të ketë çështje në shqyrtim si e caktuar për të gjykuar në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.

2. Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat që ne e kemi propozuar 1 (një) vit. Unë e ndryshoj propozimi referuar edhe qëndrimin që kemi mbajtur në vendimmarrjet e mëparshme. Propozoj tre vite, që mund të ndërpriten ose zgjaten në varësi të rrethanave.



3. Përjashtimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që kanë kaluar në seancë gjyqësore.

5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kalojmë, nëse nuk kemi diskutime.

Po!

**Brikena Ukperaj:** Kam një propozim.

Atëherë, duke marrë parasysh që skema e delegimit në rastin konkret aplikohet për t'i ardhur në ndihmë Gjykatës së Apelit Administrativ, e cila tashmë të gjithë jemi në dijeni për gjendjen në të cilën ndodhet, për ta bërë më efektive dhe më eficiente, unë kam një propozim për sa i përket pikës 4 të projektvendimit lidhur me volumin e çështjeve që gjyqtarët e skemës së delegimit (është i njëjti standard për të dyja gjyqtaret), duhet të përfundojnë në gjykatën e shkallës së parë administrative. Mendoj që për t'i vënë ato në funksionalitetin e Gjykatës së Apelit Administrativ, të ngarkohen të përfundojnë vetëm çështjet që kanë kaluar në konkluzione përfundimtare. Jo të gjitha çështjet kanë kaluar në seancë gjyqësore, sepse në këto kushte do të zvogëlohet edhe gama e papajtueshmërisë që ato mund të kenë në Gjykatën e Apelit Administrativ. Sigurisht që mund të kenë papajtueshmëri sepse në Gjykatën e Apelit Administrativ shkojnë, sigurisht kanë edhe çështje të vjetra që kanë gjykuar, por për të qenë në funksion të Gjykatës së Apelit Administrativ, do të ishte më efektive në vlerësimin tim (si ta mendojë Këshilli), që

33

çështjet që ato do të përfundojnë në gjykatën e shkallës së parë janë ato që kanë kaluar në konkluzione përfundimtare, me qëllim që të mos përsëritet shqyrtimi. Ato e kanë përfunduar shqyrtimin gjyqësor dhe janë në shpallje të vendimit dhe nuk ka kuptim. Ndërsa për çështjet e tjera, mendoj që duhet të rishpërndahen mes gjyqtarëve të tjerë në kushtet kur tashmë ka një trupë më të konsoliduar dhe ne kemi edhe tre pozicione të tjera që kemi në proces për këtë gjykatë.

**Klodian Kurushi:** Mund të bëj një koment lidhur me këtë pjesë?

**Naureda Llagami:** Po!

**Klodian Kurushi:** Ne kemi menduar dhe mendoj që është alternativa më e mirë sipas mendimit tonë, ajo çfarë kemi propozuar në relacion. Çështjet që kalojnë në gjykim në Gjykatën Administrative janë çështjet të cilat janë ezauruar pjesa më e madhe e ngarkesës në fazën përgatitore të tyre. Nëse ne do themi që do t'i lejojmë këto gjyqtare që të gjykojnë vetëm çështje që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, kam përshtypjen që mundet të shtojmë rrethin e papajtueshmërive që këto gjyqtare do përjashtojnë nga gjykimi i çështjeve si në shkallë të parë ashtu edhe në apel sepse këto gjyqtare, nëse e kanë marrë çështjen në shkallë të parë, kur të shkojnë në apel nuk do kenë mundësi që ta shqyrtojnë këtë çështje në apel. Duke qenë edhe gjyqtare të shkallës së parë, e dimë të paktën që në një fazë të gjykimit, këto do japin mendimin e tyre, konkluzionin e tyre dhe vendimin e tyre.

Kështu që, mos të konsumojmë mendoj unë, gjyqtarë të tjerë, për të gjykuar çështje ku ne e dimë që kemi probleme edhe me konsumimin e gjyqtarëve dhe numrin e gjyqtarëve dhe numrin e gjyqtarëve në gjykatat e juridiksionit të posaçëm apo edhe të përgjithshëm. Prandaj mendoj që kjo alternativa që kemi vënë neve mendoj se i përshtatet edhe rrethanave dhe kushteve konkrete ku ndodhet gjykata e shkallës së parë dhe apelit administrativ.

Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Në fakt, nuk dua të bëj debat për këtë pjesë, por mendoj që në goftë se gjyqtari nuk shprehet me vendim, nuk ka shkak për papajtueshmëri. Kështu

që, pavarësisht se ti organizon procesin, se kemi qenë të gjithë gjyqtarë që kemi shkuar në apel dhe nëse s'kishim dhënë vendim, askush nuk ka marrë vendim për papajtueshmëri, pra nuk e zgjeron. Përkundrazi, e kundërta e zgjeron rrethin e papajtueshmërive. Megjithatë, si ta vlerësojë Këshilli. Unë e bëra një propozim.

*Alban Toro:* Thjesht një shprehje shqetësimi dhe e mbyll.

Unë e nis duke falënderuar letërshkruesin, drejtuesin e Gjykatës së Apelit Administrativ, i cili ka gjetur rastin të vlerësojë punën që ka bërë KLGJ-ja në suportimin e gjykatave, veçanërisht të Gjykatës Administrative të Apelit, sikundër nuk e ka kryer kur ka qenë çelësambajtësi i fundit i Gjykatës së Lartë, madje është shprehur edhe me nota negative.

Gjithsesi unë ndaj opinionin me të gjithë ata, që gjykatat duhet të ndihmohen me çdo formë që është e mundur, me të gjitha instrumentet dhe skemat të cilat janë ligjore dhe që mundësojnë që gjykatat të lirohen nga pesha e madhe e ngarkesës që ata kanë. Por nuk mund ta them këtë për Gjykatën Administrative të Apelit e cila kemi qenë dëshmitarë në vlerësimet e kësaj trupe gjyqësore, ku është evidentuar që ka një performancë të dobët, të ulët dhe për këtë janë vlerësuar edhe me nota jo fort pozitive. Arsyet e kësaj performance nuk arrijmë t'i kuptojmë. Shkojmë edhe më tej. Edhe sot e kësaj dite, letërshkruesi për shembull vetë ka 102 dosje ose çështje të gjykuara. E pjesëtuar për 6, na dalin 17 në muaj. Ndërkohë, nëse i referohem më të keqit të Gjykatës (më fal, se ndoshta po përdor një nocion jo të përshtatshëm), por rendimentit më të ulët të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, një gjyqtar ka 94 dosje, që nuk është larg numrit të dosjeve të 102. Ndërkohë, po të marrim më të mirin e Gjykatës së Apelit Administrativ, ka gjykuar 170 dosje në 6 muaj (i bie 28 në muaj). Nëse marrim më të mirin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka gjykuar 248, pjesëtim për 6, 41 (dyfishin), që tregon që, po t'i shtojmë edhe nivelin ose llojin e gjykimit që bën apeli i juridiksionit të përgjithshëm me atë të apelit administrativ, ndërsa ky i pari është detyruar të bëjë gjykime me palë, shtyrje për efekt të palëve, e shumë problematika të tjera që shoqërojnë gjykimet, në rastin konkret, tek Gjykata Administrative, çështja është mbi bazë aktesh dhe ka shumë dhoma këshillimi. Kështu që nuk justifikohet të paktën ky rendiment dhe performancë e ulët në kryerjen e gjykimeve. Dhe tendenca për të

përdorur ngarkesën e madhe si justifikim për performancën e ulët, nuk më duket normale dhe shpresoj që kjo të mos shërbejë si ombrellë për të ardhmen, për të justifikuar këtë rendiment të ulët sepse nuk do të më pëlqente që Këshilli të përdorej për të justifikuar rendimentet dhe performancat e ulëta të gjyqtarëve. Kjo më bën skeptik në lidhje me rëndësinë që i ka dhënë letërshkruesi krijimit të kësaj skeme për këtë gjykatë. Gjithsesi ne jemi të detyruar që të suportojmë gjykatën me çdo formë të mundshme. Le ta provojmë. Shpresojmë që në të ardhmen rendimenti në këtë gjykatë do të ndryshojë, por do të sensibilizojë që kjo skemë të përdoret edhe për gjykatat e tjera, veçanërisht për atë të apelit Tiranë dhe pse jo për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Elbasan dhe Durrës, e cila ka një ngarkesë dhe performancë shumë më të lartë sesa kjo gjykatë.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit zoti Toro.

Në fakt shqetësimi juaj është shumë i drejtë për sa i përket performancës së asaj gjykate. E kemi deklaruar edhe tek raportet tona vjetore. Jo më kot Këshilli në fakt po ndërmerr hapat për pjesën e backlog-ut për të analizuar më në detaje dhe më në thellësi nga buron kjo lloj performance e ulët dhe për të gjetur mekanizmat se si ne ta luftojmë atë. Kështu që ndaj të njëjtin shqetësim me ju, sikurse të gjithë anëtarët e Këshillit. Shpresoj që me Grupin e Punës që po ngremë për backlog-un, ta adresojmë siç duhet këtë çështje.

Atëherë, meqë zonja Ukperaj ka bërë një propozim për pikën 4, hedhim në votim propozimin e zonjës Ukperaj.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet.

Kalojmë në tërësi projekt-aktin.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.
2. Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 3 (tre) vite, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përrjashtimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare.
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës.

Sërish është zoti Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. {...}. Në eventualitetin e miratimit të këtij projektvendimi i cili u miratua, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit edhe projektvendimin “Për caktimin e gjyqtarës së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Lidhur me këtë të fundit, si shkak për propozimin e këtij projektvendimi është situata në të cilën gjendet Gjykata Administrative e Apelit.

Bashkëlidhur relacionit është edhe ngarkesa për tremujorin për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Administrativ. Nuk po ndalem për t’i cituat një nga një ngarkesën e secilit gjyqtar.

Vlerësimi i Komisionit:

Meqenëse gjyqtarja znj. {...}, në supozimin e miratimit të projektvendimit të propozuar nga Komisioni (i cili tashmë u miratua) “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. {...}”, do të jetë gjyqtarja më e re e skemës së delegimit, ndërsa tre gjyqtarë të tjerë të skemës së delegimit janë caktuar tashmë nga Këshilli për plotësimin e nevojave të gjykatës së posaçme të shkallës së parë, dhe një prej tyre është caktuar për të gjykuar për llogari të gjykatës administrative të Apelit, nisur nga nevoja e Gjykatës Administrative e Apelit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar caktimin e znj. {...} në Gjykatën Administrative e Apelit, për të gjithë periudhën trevjeçare të caktimit në këtë skemë.

Lidhur me këtë situatë vlen të theksohet se zn. {...} ka përvojë profesionale rreth 20 vite, si dhe përvojën minimale profesionale që kërkon ligji, neni 47, pika 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit, rrethanë kjo që i jep të drejtë

Këshillit ta caktojë atë në gjykatën e apelit për periudhën e komandimit në skemën e delegimit, sikurse përcaktohet në shkronjën “a”, pika 4, të nenit 45.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në pesë pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se g znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative e Apelit për periudhën deri më datë... (Datën e kam lënë alternative dhe mirë është që ta diskutojmë pasi ne mendojmë që është një çështje për t’u diskutuar bashkërisht dhe ta vendosim bashkërisht se deri kur), \_\_.\_\_.2026, pikërisht deri më datën kur datohet caktimi i saj në skemën e delegimit, pra në varësi të vendimmarrjes së Këshillit në lidhje me projektvendimin “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. {...}”.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën Administrative të Apelit për një periudhë... (edhe këtë e kemi lënë në varësi të diskutimit), me përjashtim të çështjeve për të cilat do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre gjyqtarët e tjerë që gjykojnë në atë gjykatë. Kjo për të evituar ngarkesën e saj dhe mundësuar përfundimin së gjykuari të çështjeve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sikurse është parashikuar në pikën përkatëse, të projektvendimit “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarës znj. {...}”, ku përcaktohet se: “Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet... (që tashmë u ndryshua), që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet se: Ngarkohet Zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Apelit për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarës znj. {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më të lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykatë, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

Pika 4 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e efekteve juridike të vendimit, pikërisht nga data e njoftimit.

Ndërkohë në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet se efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë

Tiranë/Gjykata Administrative e Apelit (e kemi lënë alternative, pra në diskrecion të Këshillit për ta vendosur – Tek Sokoli e lamë shkalla e parë sepse e kishim lënë më përpara shkalla e parë).

Ndërsa në pikën 6 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së skemës së delegimit, znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në projektvendim përcaktohet edhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pjesa e mbetur për t’u diskutuar në Këshill dhe për ta vendosur Këshilli janë afatet e përcaktuara në pikën 1, në pikën 2 të këtij projektvendimi të propozuar. Pra gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për periudhën...

***Brikena Ukperaj: Më fal. Mundem Kryetare?***

Ne tani e miratuam caktimin e gjyqtarit në skemën e delegimit dhe atë vendimin e parë që miratuam thamë që efektet e vendimit fillojnë nga data e njoftimit. Pra nëse gjyqtarja do të njoftohet sot, që sot asaj i fillon skema e delegimit, kështu që data mund të jetë 13.07., sot jemi 13.07.2026, pra caktohet për të gjykuar për periudhën deri më 13.07.2026, meqenëse e kemi thënë 3 vjet dhe e miratuam. Ky është thjesht afati i skemës së delegimit, e para.

Ndërkohë në pikën 2, duke qenë se ne lamë që të përfundonin vetëm çështjet në konkluzionet përfundimtare, afati i përjashtimit nga shorti mund të mos jetë shumë i gjatë në Gjykatën e Apelit Administrativ. Duhet të kemi parasysh edhe diçka tjetër, që shorti aty zhvillohet çdo ditë. Me rregulloren që kemi bërë ne për shortin, short ka çdo ditë. Kështu që kjo është një gjë për t’u diskutuar. Mund ta lëmë afatin 1 javë, dy javë, mund ta lëmë në 1 shtator. Gjithsesi ne kemi bërë parashikimin që nëse ka papajtueshmëri dhe pengesë për gjyqtarët e tjerë, këto janë dy gjyqtaret që edhe pse s’janë në short, do të futen automatikisht për të plotësuar trupat gjykues. Kështu që mund ta lëmë në 1 shtator.



**Klodian Kurushi:** Atëherë, 13.07, pika e parë.

*(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)*

**Brikena Ukperaj:** Në të gjitha rastet kur kemi bërë skemat e delegimit ne, me të njëjtin parashikim e kemi bërë, me përjashtim kur kanë pengesë të tjerët, janë futur këta gjyqtarë, sepse edhe gjyqtarët e tjerë që caktojmë janë gjyqtarë të skemës së delegimit. Vetëm nëse nuk ke, do caktosh nga gjyqtarët...

Në qoftë se ke dy gjyqtarë në skemë delegimi, ato do caktosh.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 13.07.2026.

2. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 01.09.2023, me përjashtim të çështjeve për të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre.

3. Ngarkohet Zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Apelit për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim

që ngarkesa e punës së gjyqtares {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

4. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së skemës së delegimit, znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës Administrative e Shkallës së parë Tiranë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

\* \* \*

(Pika 7 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

8.1 “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”.

8.2 “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                    |                   |
|--------------------|-------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare)        |
| 2. Ilir Rusi       | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar)          |
| 4. Fatmira Luli    | (anëtare)         |
| 5. Irena Plaku     | (anëtare)         |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar)          |
| 7. Ridvan Hado     | (anëtar)          |
| 8. Alban Toro      | (anëtar)          |
| 9. Marçela Shehu   | (anëtare)         |

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI).**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

8.1 “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”.

8.2 “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me caktimin në skemë delegimi të zonjës {...}.

Sërish fjalën e ka zoti Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit!

Bashkëlidhur relacionit për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...} është paraqitur edhe projektvendimi përkatës i cili është strukturuar gjithsej në 6 pika.

Janë të njëjtat rrethana dhe e njëjta situatë që unë parashtrova edhe në relacionin pararendës që i referohej gjyqtares zonjës {...}. Kështu që, nëse kolegët bien dakord, për të mos referuar të njëjtat rrethana, e njëjta gjykatë, të njëjtën ngarkesë kanë gjyqtarët, e

njëjta situatë parashikohet edhe për zonjën {...}. Kështu që, unë kaloj direkt në pjesën e projektvendimit përkatës, nëse kolegët janë dakord.

Atëherë, ne përfundimisht i propozojmë Këshillit:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.

2. Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat (e kemi shënuar 1) unë po e ndryshoj dhe po propozoj 3 vite, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.

3. Përfundimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare.

5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit të tij.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.  
Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës.

Sërish e ka fjalën z. Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit!

Atëherë, është e njëjta situatë që ne diskutuam, u dakordësuam dhe vendosëm për rastin e zonjës {...}, duke e caktuar gjyqtare në skemën e delegimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Kështu që edhe në këtë rast unë mendoj që, nëse edhe kolegët janë dakord, të kaloj në fazën e propozimeve konkrete që ka sjellë Komisioni në mbledhje.

Pra përfundimisht, ne propozojmë:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 13.07.2026.

2. Gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën Administrative të Apelit për periudhën deri më datë 01.09.2023, me përjashtim të çështjeve për të cilat gjyqtarët e kësaj gjykate do të kenë pengesë ligjore për gjykimin e tyre.

3. Ngarkohet Zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Apelit për përcaktimin e numrit dhe të rrethit të çështjeve që do të rindahen me short, me qëllim që ngarkesa e punës së gjyqtarës znj. {...}, për aq sa është e mundur, të jetë jo më e lartë se numri mesatar i çështjeve për gjyqtar të asaj gjykate, si dhe të përfshijë çështje të të gjitha kategorive dhe të së njëjtës vjetërsi sipas kohës së regjistrimit të tyre, për të cilat nuk janë kryer veprime apo shpallur për gjykim nga gjyqtarët relatorë.

4. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë. [...]

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Kurushi!  
Atëherë, nëse s'kemi diskutime, kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga relatori.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit.

\* \* \*

(Pika 8 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)



**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër e radhës që ka të bëjë me mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për gjyqtaren {...}. Për më shumë detaje, fjalën e ka zonja Plaku.

*Irena Plaku:* Faleminderit!

Atëherë, po ju paraqes shkurtimisht relacionin për projektvendimin “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtaren {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 të Ligjit për Statusin si dhe Vendimit nr. 263 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka

49

për detyrë të fillojë procedurën e vlerësimit të gjyqtarëve për periudhën e gradimit. Ndër gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e vlerësimit kalimtar është edhe znj. {...}, dosja e së cilës është depozituar pranë KLGJ-së në datën 29.06.2023, ku është përcjellë si dosja e rivlerësimit ashtu edhe vendimi në të cilin është bërë konfirmimi i saj në detyrë, vendim i cili ka marrë formë të prerë për shkak se nuk është konfirmuar.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të dosjes rezulton se për periudhën tetor 2013 - korrik 2016, ku përfshihet edhe periudha e vlerësimit për gradimin, rezulton se gjyqtarja ka qenë në Shkollën e Magjistraturës. Nga nëntori 2015 deri në muajin korrik 2016 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe me vendimin nr.13, datë 10.02.2017 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është caktuar të ushtrojë funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Rezulton se gjatë gjithë periudhës tetor 2013-tetor 2016, gjyqtarja {...} nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarës por gjatë periudhës nëntor 2015 – korrik 2016 (për një periudhë prej 8 muaj e 11 ditë) ka qenë e caktuar për të kryer stazhin profesional dhe duke pasur dhe duke qenë në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës.

Viti i tretë i Shkollës së Magjistraturës, referuar ligjit të Shkollës së Magjistraturës që ka qenë në fuqi, konkretisht ligji nr.8136, datë 31.07.1996, përfshihet në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës dhe në përfundim të saj vlerësohet me qëllim renditjen e gjyqtarës.

Në bazë të nenit 171, pika 5 e Ligjit për Statusin Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve për aq sa kjo është e mundur, me qëllim përcaktimin e gradës së vlerësimit.

Referuar faktit se gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarës së caktuar pas përfundimit të periudhës së stazhit, periudhë e cila ka qenë në vlerësim nga Shkolla e Magjistraturës, vlerësohet se nuk është e mundur të kryhet vlerësimi i saj, për shkak se nuk ka një vit punë në detyrë, referuar edhe nenit 5 të vendimit 263 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Administrative në një rast tjetër, në vendimin nr.86, datë 07.12.2022 e cila ka vendosur se në rastet kur është e pamundur që të kryhet procedura e vlerësimit, nuk plotësohen kushtet, duhet të vendoset mosfillimi i saj.

Referuar sa më sipër, duke qenë se është në pamundësi të kryerjes së procedurës së vlerësimit, Komisioni ka propozuar që të vendoset mosfillimi i procedurës së vlerësimit për periudhën e gradimit për gjyqtaren {...}, për periudhën 2013-2016. Ndërkohë për periudhën 2017-2019 kjo e fundit është në procedurë vlerësimi.

Në projektvendim përcaktohet si më poshtë:

Përcaktohet mosfillimi i procedurës së vlerësimit për gjyqtaren {...}, për periudhën 2013-2016, pasi nuk plotësohen kushtet për fillimin e kësaj procedure, në kushtet kur gjyqtarja nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtares pranë gjykatës së rrethit gjyqësor ku është caktuar.

Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtares.

Në pikën 3 të projektvendimi parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ individual.

Së fundi, hyrja në fuqi e tij menjëherë dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur.

\* \* \*

(Pika 9 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin [...]”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).<sup>1</sup>

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)

<sup>1</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 12-ta sipas rendit të ditës.

9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin [...]”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër.

Sa të bëhet gati shorti, kalojmë tek çështja tjetër, po me Irena Plaku, për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, për gjyqtarin [...].

*Irena Plaku:* Faleminderit!

Shkurtimisht po ju paraqes relacionin tjetër për miratimin e projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin [...]”.

Në ndryshim nga gjyqtari i mëparshëm, për këtë gjyqtar ka filluar procedura e vlerësimit për periudhë e gradimit me vendimin nr. 81, datë 16.02.2023, të KLGJ-së, pas përfundimit me sukses të procesit të rivlerësimit për këtë gjyqtar.

Nëpërmjet këtij vendimi, bazuar në procedurën e shortit, jam zgjedhur unë si relatore.

Në datë 17.02.2023, është njoftuar gjyqtari i cili ka qenë dakord.

Në vijim të procedurës së vlerësimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit, ka rezultuar se:

Z. [...] është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {...}, datë 30.08.1996 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku ka punuar deri në datë 19.09.2000. Nga data 19.09.2000 deri në datën 07.03.2016, ai ka ushtruar disa detyra pranë Ministrisë së Drejtësisë apo edhe Avokatit të Popullit. Me vendimin nr. {...}, datë 07.03.2016 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ai është emëruar gjyqtar, duke u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa më sipër, rezulton se, gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013-tetor 2016, z. [...] ka ushtruar detyrën e gjyqtarit vetëm për një periudhë 07.03.2016 deri në datën 08.10.2016, për një kohëzgjatje prej 7 muajsh. Gjithashtu edhe po ta marrim periudhën e vlerësimit deri në datë 31.12.2016, rezulton se ai ka ushtruar detyrën e gjyqtarit për një kohëzgjatje prej 9 muajsh e 24 ditë.

Duke qenë se referuar rregullave, nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin, nenit 84 të Ligjit për Statusin, kur magjistrati vlerësohet për një periudhë 5-vjeçare apo 3-vjeçare, dhe sidomos vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 263, në nenin 5, pika 4, ka përcaktuar se: Gjatë periudhës së vlerësimit, tre ose pesëvjeçare, Këshilli vlerëson gjyqtarin, pavarësisht nga koha e ushtrimit prej tij të detyrës, e cila gjithsesi nuk mund të jetë më pak se një vit.”

Duke qenë se ka rezultuar se për këtë periudhë 2013-2016 gjyqtari ka ushtruar detyrën e gjyqtarit për më pas se 1 vit, kemi propozuar që të vendoset përfundimi i procedurës së vlerësimit të filluar për këtë gjyqtar, për shkak se nuk është e mundur të bëhet vlerësimi i kësaj periudhe për shkak se është më pak se 1 vit.

Në pikë e parë të projektvendimit përcaktohet përfundimi pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të

vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për shkak se objekti për të cilën kishte nisur kjo procedurë është i pamundur të realizohet, pasi koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

Në pikën e dytë përcaktohet që një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet gjyqtarit.

Në pikën e tretë përcaktohet e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi si dhe së fundmi përcaktohet hyrja në fuqi, konkretisht menjëherë dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

\* \* \*

(Pika 10 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

***Pika 11 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.7.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Naureda Llagami</i></b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b><i>2. Ilir Rusi</i></b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>3. Klodian Kurushi</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>4. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Irena Plaku</i></b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Dritan Hallunaj</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>7. Ridvan Hado</i></b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>8. Alban Toro</i></b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

<sup>2</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 15-ta sipas rendit të ditës.

9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerita Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.7.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Për efekt të menaxhimit të kohës, kalojmë edhe projekt-aktin që ka të bëjë me fillimin e procedurës për përzgjedhjen për ngritjen në detyrë në gjykatën e posaçme, më pas bëjmë shortet dhe në fund vlerësimet. Si e mendoni?

*(Anëtarët bien dakord.)*

Kështu që fjalën ia jap zotit Kurushi.

*Klodian Kurushi:* Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore dhe me miratimin edhe të Vendimit nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në kohë të ndryshme, ka

hapur disa procedura ngritjeje në detyrë të gjyqtarëve, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pikërisht me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021.

Brenda afatit të kandidimit në këtë procedurë ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 16.04.2021, kandidoi vetëm një kandidat, konkretisht gjyqtarja znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, aktualisht gjyqtare e skemës së delegimit, e caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në procedurën e ngritjes në detyrë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, ka përfunduar procedura e verifikimit për kandidaten e vetme znj. {...}, për të cilën, Këshilli, me vendimin e datës 13.07.2023, ndër të tjera, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për këtë kandidate ka përfunduar gjithashtu procedura e vlerësimit etik dhe profesional nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Sa më sipër, rezulton se në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, kandidatja e vetme znj. {...} është kualifikuar.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Propozimi i Komisionit -

Nëpërmjet këtij projektvendimi, sipas pikës 1 të tij, Këshillit i propozohet të vendosë fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas këtij projektvendimi, pikës 2, të tij, Këshilli do të duhet të caktojë relatorin për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pozicionin e lirë si më lart.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në këtë rast ka vlerësuar se relatori i caktuar me vendim të Këshillit, për çështjet e përzgjedhjes lidhur me pozicionin e shpallur me vendimin nr. 125, nr. 123 dhe nr. 128, datë 01.04.2021 do të duhet të caktohet relator edhe për procedurën e përzgjedhjes që propozohet të fillohet sipas projektvendimit, pra për çështjet e përzgjedhjes për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 287, datë 06.7.2021.

Në këtë rast, ne propozojmë që relatori të jetë z. Toro. Ky propozim sillet në mbledhjen e Këshillit duke mbajtur në konsideratë për këtë praktikën e ndjekur deri më sot për shpërndarjen e ngarkesës së punës, ku me synimin e administrimit sa më të mirë dhe më me efikasitet të këtij procesi si relator në procedurën/at e përzgjedhjes të filluara rishtazi është caktuar anëtari i Komisionit, që është caktuar përmes shortit, si relator për procedurat e tjera të përzgjedhjes të filluara më parë, në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në të njëjtën gjykatë. Përjashtim nga ky rregull i ndjekur kanë qenë rastet kur në një gjykatë ka pasur shumë pozicione të lira në proces, në më shumë se një fushë të së drejtës dhe me disa kandidatë për çdo pozicion. Në këto raste relatori është caktuar përmes shortit, sipas fushave të së drejtës së pozicioneve të lira në proces. Rasti në shqyrtim nuk është i tillë.

Së fundi, në projektvendim parashikohet dhe momenti i hyrjes së tij në fuqi, konkretisht menjëherë dhe të botohet ky vendim në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, projekt-akti miratohet sipas propozimit nga ana e Komisionit.

\* \* \*

(Pika 11 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 12 shtesë e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).<sup>3</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

<sup>3</sup> Kjo çështje është çështja e cila u shtua në rendin e ditës.

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

12. (pika shtesë) Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti që ka të bëjë me ngritjen në detyrë të gjyqtares në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, znj. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Toro.

**Alban Toro:** Më herët nga ana e Këshillit me vendimin nr. 363, datë 13.07.2023, është miratuar renditja e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 128, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku e vetme në këtë kandidim është renditur zonja {...}.

Vendimi sipas pikës 16, të këtij relacioni, më datë 13.07.2023, iu njoftua rregullisht kandidates znj. {...}, e cila, bazuar në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonte të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

Kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike po me të njëjtën datë konfirmoi marrjen e njoftimit për vendimin si më lart të Këshillit. Po ashtu, kjo candidate, në rrugë elektronike, po në këtë datë, i bëri të ditur Këshillit të Lartë Gjyqësor se nuk ka ankim ndaj vendimit.

Në kushtet kur kandidatja e vetme ka konfirmuar marrjen e vendimit për renditjen e kandidatëve nr. 363, datë 13.07.2023, si dhe ka deklaruar se nuk kanë ankim ndaj tij, ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

Për rrjedhojë, në zbatim të pikës 68, të vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, relatori i procedurës së përzgjedhjes ka përgatitur projektvendimin bashkëlidhur, ku në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë me datë 14.07.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.



***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni për ngritjen në detyrë të gjyqtarës në gjykatën e posaçme, znj. {...}.

\* \* \*

(Pika 12 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 13 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>4</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

<sup>4</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës.

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Tani bëhemi gati nga ana e stafit për shortet.

Kemi dy projekt-akte radhazi që kanë të bëjnë me fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit për ato kandidatë që kanë ose mund të kenë një vlerësim.

Administrata!

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: zoti Alban Toro (i cili do të jetë relator për dy kandidatë), zoti Dritan Hallunaj (i cili do të jetë relator për dy kandidatë) dhe zoti Klodian Kurushi (i cili do të jetë relator për një kandidat).

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjidhet emri i relatorit të parë, z. Dritan Hallunaj, i cili do të jetë relator për dy kandidatë. Kandidatët e përzgjedhur nga shorti janë znj. {...} dhe znj. {...}. Zoti Hallunaj do të jetë relator për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të dytë, z. Alban Toro, i cili do të jetë relator për dy kandidatë. Kandidatët e përzgjedhur nga shorti janë z. {...} dhe znj. {...}. Zoti Toro do të jetë relator për kandidatët z. {...} dhe znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të tretë, z. Klodian Kurushi, i cili do të jetë relator për një kandidat. Kandidati i përzgjedhur (i mbetur në enën e qelqit) është z. {...}. Zoti Kurushi do të jetë relator për kandidatin z. {...}.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit!

Atëherë, pas hedhjes së shortit, nëse jemi dakord me procedurën, kalojmë në votim projekt-aktin.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
2. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
3. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
4. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
5. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj.

3. Për kandidatët znj. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë kandiduar në procedurat e lëvizjes paralele, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023, procedura e verifikimit të kriterëve ligjore që ka përfunduar për këtë kandidim, është e vlefshme edhe për kandidimin e tyre për lëvizjen paralele, të shpallur me vendimet nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 13 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 14 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>5</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>5</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 13-ta sipas rendit të ditës.

**10. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**11. Yllka Rupa** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek akti tjetër. Edhe ky ka të bëjë me një procedurë shorti.

Siç jeni në dijeni, kanë ardhur të gjithë emrat e kandidatëve magjistratë për të cilët kërkohet të bëhet verifikimi i kriterëve për formimin fillestar. Pa humbur kohë, janë rreth 40 kandidatë, kalojmë në hedhjen e shortit.

Komisioni ka ardhur me propozimin që të ndahen në mënyrë të tillë ku katërbëdhjetë do ketë zoti Klodian Kurushi, trembëdhjetë do ketë zoti Hallunaj dhe trembëdhjetë zoti Toro.

Atëherë, vijoni me procedurën e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: zoti Klodian Kurushi (i cili do të jetë relator për 14 kandidatë), zoti Dritan Hallunaj (i cili do të jetë relator për 13 kandidatë) dhe zoti Alban Toro (i cili do të jetë relator për 13 kandidatë).

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: 1. znj. {...}; 2. z. {...}; 3. znj. {...}; 4. znj. {...}; 5. znj. {...}; 6. z. {...}; 7. z. {...}; 8. znj. {...}; 9. znj. {...}; 10. znj. {...}; 11. znj. {...}; 12. znj. {...}; 13. z. {...}; 14. znj. {...}; 15. znj. {...}; 16. znj. {...}; 17. znj. {...}; 18. znj. {...}; 19. znj. {...}, 20. znj. {...}; 21. znj. {...}; 22. znj. {...}; 23. znj. {...}; 24. znj. {...}; 25. znj. {...}; 26. z. {...}; 27. z. {...}; 28. znj. {...}; 29. znj. {...}; 30. znj. {...}; 31. znj. {...}; 32. znj. {...}; 33. znj. {...}; 34. znj. {...}; 35. znj. {...}; 36. znj. {...}; 37. znj. {...}; 38. znj. {...}; 39. znj. {...}; 40. z. {...}.

Procedura e përzgjedhjes:

Përzgjidhet emri i relatorit të parë, z. Alban Toro, i cili do të jetë relator për 13 kandidatë. Kandidatët e përzgjedhur nga shorti janë: 39. znj. {...}, 7. z. {...}, 23. znj. {...}, 15. znj. {...}, 17. znj. {...}, 24. znj. {...}, 8. znj. {...}, 31. znj. {...}, 9. znj. {...}, 22. znj. {...}, 14. znj. {...}, 1. znj. {...}, 5. znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të dytë, z. Dritan Hallunaj, i cili do të jetë relator për 13 kandidatë. Kandidatët e përzgjedhur nga shorti janë: 6. z. {...}, 32. znj. {...}, 11. znj. {...}, 33. znj. {...}, 26. z. {...}, 25. znj. {...}, 13. z. {...}, 21. znj. {...}, 4. znj. {...}, 35. znj. {...}, 34. znj. {...}, 10. znj. {...}, 29. znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të tretë, z. Klodian Kurushi, i cili do të jetë relator për 14 kandidatë. Kandidatët e përzgjedhur nga shorti janë: 28. znj. {...}, 27. z. {...}, 2. z. {...}, 18. znj. {...}, 12. znj. {...}, 36. znj. {...}, 40. z. {...}, 3. znj. {...}, 38. znj. {...}, 16. znj. {...}, 30. znj. {...}, 37. znj. {...}, 20. znj. {...}, 19. znj. {...}.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Pasi përfunduar procedurën, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.



**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
2. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
3. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
4. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
5. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
6. Për kandidatin z. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
7. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
8. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
9. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
10. Për kandidaten znj. {...} , relator z. Dritan Hallunaj;
11. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
12. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
13. Për kandidatin z. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
14. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
15. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
16. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
17. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
18. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
19. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
20. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;

21. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
22. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
23. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
24. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
25. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
26. Për kandidatin z. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
27. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
28. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
29. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
30. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
31. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
32. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
33. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
34. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
35. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Dritan Hallunaj;
36. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
37. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
38. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
39. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
40. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*Naureda Llagami*: Atëherë, 5 minuta pushim dhe do vijojmë “online” për tre çështjet e fundit.

\* \* \*

(Pika 14 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 15 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017–2019, relatores znj. Yllka Rupa.<sup>6</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>6</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 11-ta sipas rendit të ditës.

**Shënim:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

15. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017–2019, relatore *znj. Yllka Rupa*.

*Pas disa minutash pushim, vijon mbledhja nëpërmjet platformës “online”, në ambientet e Këshillit, nën drejtimin e Zëvendëskryetarit, z. Ilir Rusi.*

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me pikën përkatëse që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017–2019, me relatore *znj. Yllka Rupa*. Për më tej fjalën relatores, *znj. Rupa*.

**Yllka Rupa:** Faleminderit!

Të nderuar kolegë!

Po relatoj projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}, përgatitur për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019, periudhë gjatë së cilës gjyqtari ka ushtruar funksionin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe njëkohësisht për një periudhë kohore në Gjykatën Administrative të

Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pukë.

Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarit në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale të tij. Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim, mbi të cilin përcaktohet niveli i vlerësimit për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit, si dhe ai i përgjithshëm, të cilat unë do t'i propozoj sot për miratim përpara mbledhjes plenare.

Në projektraport është e pasqyruar në mënyrë të plotë procedura e ndjekur për vlerësimin e gjyqtarit. Po ndaloj në paraqitjen e konkluzioneve në mënyrë të përmbledhur lidhur me analizën e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimin për nivelin e vlerësimit për çdonjërin nga 4 kriteret.

Duke filluar me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”.

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

Në lidhje me Njohuritë ligjore, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton në tërësi se gjyqtari shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës të qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, duke i integruar dhe me një analizë të detajuar të provave. Evidentohen aftësitë e gjyqtarit në lidhje me identifikimin dhe përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes. Pra në tërësi rezulton se gjyqtari shfaq aftësi shumë të mira në lidhje me përcaktimin e natyrës juridike të marrëdhënies objekt shqyrtimi, si dhe identifikimi i normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktet objekt shqyrtimi.

Në lidhje me këtë tregues, propozoj nivelin e vlerësimit shumë të lartë, dhe pikëzimin me 25 pikë.

Në lidhje me 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, (*relatohet konkluzioni për nënkriterin 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit*), referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkuese, në çdo nënndarje të saj në funksion të kuptueshmërisë së vendimit.

Në lidhje me këtë komponent vlerësoj që niveli i vlerësimit të propozohet shumë i lartë dhe niveli i pikëzimit me 15 pikë. (*1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes është pikëzuar me 25 pikë.*)

Për të kaluar tek 1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit gjyqësor. Edhe në këtë komponent evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit. Kjo mënyrë e standardizuar e të shkruarit të vendimit gjyqësor, orienton lexuesin dhe i shërben kuptueshmërisë së logjikës juridike për atë që është konkluduar.

Edhe në lidhje me këtë komponent vlerësoj që niveli i vlerësimit për këtë gjyqtar të jetë shumë i lartë dhe pikëzimi me 10 pikë.

Për të kaluar tek 1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, i detajuar dhe i qartë, ku në çdo vendim burim vlerësimi, gjyqtari fillimisht merr në analizë ligjin e zbatueshëm. Arsyetimi i vendimeve burim vlerësimi ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil, penal apo administrativ), duke bërë një analizë tërësore të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Dispozitat ligjore interpretohen si dhe aplikohen mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të zgjidhjes së saj. Gjyqtari, analizon institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura në lidhje me natyrën e mosmarrëveshjes si dhe të zgjidhjes së saj në themel.

Lidhur me këtë komponent propozoj gjithashtu një nivel vlerësimi shumë i lartë, pikëzimi me 25 pikë.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi për nivelin e kriterit “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtarit”.

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në trupë gjyqësore me të tjerë.

Në lidhje me “Aftësitë organizative” vlerësohen së pari “Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë” dhe “Aftësia për të kryer e për të realizuar procedura gjyqësore”. Në lidhje me treguesin e parë do të prezantoj 2.A.a Respektimin e afateve ligjore. Në lidhje me këtë komponent, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore, për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar në total 165 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 37 janë jashtë këtij afati. Referuar Raportit Analitik, çështjet të cilat kanë rezultuar të gjykuara jashtë afateve ligjore i përkasin kategorive: “Kundërshtim i veprimeve përmbarimore” (13 çështje); “Lëshim urdhër ekzekutimi” (6 çështje); “Sigurim padie” (15 çështje); “Shlyerje afati ekzekutimi” (1 çështje); “Revokim i masës së sigurimit” (1 çështje); “Ankim kundër vendimit të pushimit të procedimit penal”, (1 çështje).

Në total, sipas analizës vetëm matematikore që rezulton nga Raporti Analitik, gjyqtari ka gjykuar 37 çështje jashtë afateve ligjore, nga 165 çështje në total për të cilat ligji parashikon afate ligjore gjykimi, që përbëjnë 22% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 37 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, evidentohet se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e kalimit me short në një kohë të mëvonshme nga data e regjistrimit apo këto vonesa kanë qenë të papërfillshme. Konkretisht:

- Për çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore” , rezulton se gjykimi për 1 çështje është tejkalluar vetëm në 1 ditë, tejkallim i cili vlerësohet i pakonsiderueshëm dhe si i tillë kjo çështje do të konsiderohet e shqyrtuar brenda afatit ligjor. Gjithashtu, për 1 çështje gjykimi është tejkalluar për 12 ditë dhe nga të dhënat

statistikore, rezulton që është hedhur në short në datë 07.12.2017 dhe është përfunduar në datë 08.01.2018, pra gjatë periudhës së fundvitit, e cila përkon dhe me procesin e mbartjes së dosjeve nga administrata gjyqësore dhe do të konsiderohet brenda afatit ligjor.

- Për çështjet me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi”, nëse përlogaritja e afatit të gjykimit do të fillonte nga data e caktimit të çështjes me short, atëherë këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 510 të K.Pr.Civile. Për pasojë këto çështje nuk duhet të përfshihen në çështjet e përfunduara jashtë afatit ligjor, duke qenë se kohëzgjatja e tyre ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

- Për çështjet me objekt “Sigurim padie”, konkretisht për 3 prej tyre, vendimi është marrë për një afat prej 6 apo 7 ditësh, duke tejkeluar afatin ligjor me 1 dhe 2 ditë, tejkallim ky i cili vlerësohet i pakonsiderueshëm dhe si i tillë këto çështje konsiderohen të shqyrtuara në afat ligjor 5-ditor të parashikuar në nenin 28, pika 3 të ligjit nr.49/2012.

- Për çështjen me objekt “Shtyrje afat ekzekutimi”, vendimi është marrë për një afat prej 21 ditësh, duke tejkeluar afatin ligjor me 1 ditë, tejkallim ky i cili vlerësohet i pakonsiderueshëm dhe si i tillë kjo çështje konsiderohet e shqyrtuar brenda afatit 20-ditor të parashikuar nga ligji.

Nga një rillogaritje matematikore e përqindjes së çështjeve të shqyrtuara tej afateve ligjore, duke zbritur nga totali prej 37 çështjesh, 12 çështjet e mësipërme të cilat duhet të konsiderohen në afat, pasi tejkallimi i afatit nuk ka ndodhur për shkak të gjyqtarit, apo ky tejkallim ka qenë i papërfillshëm, rezulton se kjo përqindje është 15 %, përqindje e cila sipas metodologjisë përkon me nivelin e vlerësimit prej 12 (dymbëdhjetë) pikësh.

Në metodologji, lidhur më këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.



Duke vlerësuar të gjithë këto komponentë, propozoj që në lidhje me këtë tregues gjyqtari të pikëzohet me 15 pikë.

Në lidhje me komponentin tjetër 2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka ushtruar funksionin e tij në dy gjykata, përkatësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Për periudhën që ka ushtruar funksionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, analiza e të dhënave statistikore për këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar vendimit të ish-KLD nr. 261/2, datë 14.04.2010. Për periudhën që ka ushtruar funksionin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, analiza e të dhënave në lidhje me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar Vendimit të ish-KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010 dhe ligjit nr.49/2012. Pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Këto afate presupozohet që gjykimi i një çështjeje në gjykatën administrative do të përfundonte për një afat prej 87 ditësh. Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të nevojshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues.

Rezulton se në total, gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka gjykuar 793 çështje për të cilat parashikohen afate orientuese gjykimi në lidhje me standardin minimal kohor, prej të cilave 355 çështje janë shqyrtuar jashtë këtij afati, ose që përbëjnë 44.7% të tyre.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, sipas një llogaritjeje vetëm matematikore, përqindja e çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor, është 67% dhe pikëzohet me 1 pikë. Por, referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në pikëzim maksimal, duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit. Në rastin konkret, sa i përket treguesit sasior të punës së gjyqtarit, rezulton se për periudhën e vlerësimit, duke marrë në konsideratë;

- afatin e gjykimit të çështjeve administrative për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, duke pranuar si të tillë afatin 87-ditor dhe jo 1-mujor;

- shkaqeve që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit, sikurse është ngarkesa e lartë e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit si dhe faktit që gjyqtari gjatë periudhës 14.06.2018 - 20.12.2018 ka ushtruar funksionin njëkohësisht në dy gjykata, të cilat kanë ndikuar në pamundësinë e mosrespektimit të standardeve orientuese të përfundimit të gjykimit të çështjeve;

- treguesin sasior të punës, ku rezulton se gjyqtari;

(i) Gjatë vitit 2017 dhe 2018, në kushtet kur për një periudhë të caktuar gjyqtari ka gjykuar në të dy gjykatat, në lidhje me përcaktimin e treguesit sasior, do t'i referohemi pikës 3 germa g, të vendimit nr. nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së, "Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore", nga ku rezulton se ka realizuar standardin minimal sasior të punës dhe e ka tejkaluar atë 13.5%.

(ii) Gjatë vitit 2019 ka realizuar standardin minimal sasior të punës dhe e ka tejkaluar atë në 53.9% sipas pikës 3, germa c të "Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore", miratuar me vendimin e sipërcituar.

- natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve.

Për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, me atë që unë parashtrova, propozohet që gjyqtari në lidhje me këtë komponent të pikëzohet me 3 pikë.

Në lidhje me 2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, duke iu referuar vetëm analizës matematikore, nga të dhënat statistikore rezulton se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 4 pikë, pasi koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është "Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve" por, duke u bazuar në të njëjtat argumente si për treguesin e "Plotësimin të standardeve minimale kohore" bazuar në analizën logjike të të dhënave statistikore, gjyqtari duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga analiza e thjeshtë e fakteve. Për këtë arsye unë propozoj që në lidhje me këtë komponent, gjyqtari të pikëzohet me 5 pikë.

Në lidhje me 2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore, një komponent tjetër ky që vlerësohet në kuadër të kriterit të dytë, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të

çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara, me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik, është 64%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit që i përket ushtrimit të funksionit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, gjyqtari duke bërë një analizim të të dhënave statistikore, e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mbi mesatar, ndërsa në formularin e vetëvlerësimit që i përket ushtrimit të funksionit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, sipas një analize statistikore të bërë prej tij, e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mesatar. Gjithashtu, për këtë periudhë, gjyqtari paraqet disa shkaqe të cilat kanë ndikuar në nivelin e rendimentit të tilla si:

Marrja në dorëzim me short manual më datë 27 qershor 2018, gjithsej 177 çështje, përveç atyre të caktuara në bazë të shorteve periodike, 482 çështje të shortuara nga data 27 qershor 2018 deri më datë 31 dhjetor 2018;

Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, njëkohësisht në dy gjykata;

Ushtrimi edhe i detyrës së zv/kryetarit gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2019 e në vijim.

Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë, ndërsa Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka vlerësuar gjyqtarin në shkallën mesatare në lidhje me këtë tregues. Arsyetimi i kryetarëve të gjykatave respektive është bërë mbi bazën e një analize të të dhënave statistikore.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe të dhënave statistikore, vlerësohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtari, pavarësisht se rezulton të jetë 64%, duhet të pikëzohet me 6 pikë referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për shkak të rritjes së papritur të volumit të çështjeve dhe ngarkesës së punës të analizuara më sipër.

Për këto arsye, vlerësoj që niveli i pikëzimit për këtë gjyqtar në lidhje me këtë tregues, duhet të jetë 6 pikë.

Për të kaluar tek treguesi tjetër 2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor. Nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, është më e shkurtër ose e

barabartë me afatin procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe për këtë arsye, në lidhje me këtë komponent, gjyqtari duhet të vlerësohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore analizohet mbi bazën e disa komponentëve, së pari 2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 19 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2 seanca dhe gjyqtari në të gjitha çështjet ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre. Për këto arsye propozohet niveli i pikëzimit për këtë komponent me 15 pikë.

Për të kaluar tek 2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor. Në tërësi edhe në lidhje me këtë komponent, referuar të dhënave që pasqyrohen në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Për këtë arsye vlerësoj që niveli i vlerësimit për këtë tregues të jetë shumë i lartë dhe i pikëzimit 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore, në dy komponentët: 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes dhe 2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes. Në lidhje me komponentin e parë rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Për këto arsye propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, niveli i pikëzimit me 5 pikë.

Në lidhje me 2.C.b Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, gjithashtu nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në lidhje me këtë tregues dhe për këtë arsye propozohet nivel i vlerësimit shumë i lartë, niveli i pikëzimit me 10 pikë.

Në lidhje me kriterin e dytë “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikëzimi 94 pikë.

Për të kaluar tek “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”.

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

Në lidhje me Etikën në punë 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtarin {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, ndaj gjyqtarit rezulton të jenë paraqitur 3 (tre) ankesa, për të cilat ILD ka vendosur arkivimin e tyre.

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna për cenimin e etikës në punë të gjyqtarit subjekt vlerësimi dhe në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion dhe propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, niveli i pikëzimit 35 pikë.

Për të kaluar tek Integriteti i gjyqtarit, 3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti, referuar prezumimit dhe përcaktimeve të metodologjisë së pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Në lidhje me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, niveli i pikëzimit 40 pikë.

Në lidhje me Paanësinë e gjyqtarit, 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese, nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Për këtë arsye propozohet për këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë dhe niveli i pikëzimit me 10 pikë.

Sa i takon 3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit, janë paraqitur 10 (dhjetë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, të cilat janë rrëzuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtari ka paraqitur 30 (tridhjetë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 24 (njëzet e katër) janë pranuar. Në këto kushte vlerësoj se ky numër duhet të vlerësohet i pakonsiderueshëm dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Në lidhje me kriterin e tretë atë të “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, niveli i vlerësimit propozohet "Shkëlqyeshëm" dhe niveli i pikëzimit 100 pikë.

Në lidhje me kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

#### 4.A Aftësia e komunikimit, 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces përdor fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta për të shprehur mendimin. Ai ndërton përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare. Megjithatë, konstatohet edhe ndërtimi i fjalive të gjata me qëllim të mos ndërpresë logjikën e arsyetimit.

Në lidhje me këtë komponent rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, dhe për këtë arsye propozohet nivel i vlerësimit shumë i lartë, dhe niveli i pikëzimit me 25 pikë.

Për të kaluar tek 4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Për këtë arsye propozohet niveli i vlerësimit i lartë dhe niveli i vlerësimit 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar paraqitet gjithashtu në nivele të larta si në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, po ashtu edhe shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Për të dy këto komponentë për gjyqtarin propozohet vlerësimi shumë i lartë dhe pikëzimi përkatësisht 15 dhe 10 pikë.

Në lidhje me 4.C Gatishmërinë e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, komponenti 4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 22 (njëzet e dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 35 ditë trajnimi. Në projektraport janë të pasqyruara të gjitha aktivitetet në mënyrë të detajuar dhe duke qenë në këto kushte, lidhur me këtë komponent, propozohet niveli i pikëzimit me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk është angazhuar në aktivitete si ekspert/lehtësues në programe të trajnimit fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në lidhje me këtë komponent ai duhet të vlerësohet me 3 pikë.

Për sa i përket 4.C.c Pjesëmarrjes së tij në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata, gjithashtu nuk rezultojnë të dhëna për periudhën e vlerësimit nga dosja personale e gjyqtarit, apo të dhëna nga burimet e vlerësimit në lidhje me pjesëmarrjen e tij në

veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Për këtë arsye, lidhur me këtë tregues, gjyqtari propozohet të vlerësohet me 3 pikë.

Edhe në lidhje me 4.C.ç Publikimet ligjore akademike, nuk rezulton që ky gjyqtar të jetë përfshirë në aktivitete të tilla, pra që të ketë publikime ligjore apo akademike dhe për rrjedhojë nuk vlerësohet në lidhje me këtë komponent. Pra është 0 vlerësimi.

Në këto kushte, duke u mbështetur në nivelin e vlerësimit dhe pikëzimit për gjithsecilin për komponentët e kriterit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional i gjyqtarit”, rezulton niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", niveli i pikëzimit 91 pikë.

Në mënyrë të përmbledhur propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit për gjyqtarin {...} paraqitet si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative të gjyqtarit , 94 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikëzimi 385 pikë.

Në lidhje me propozimet dhe rekomandimet, duke iu referuar të dhënave të analizuarra dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandoj që gjyqtari {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

Faleminderit për vëmendjen!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Rupa!

Ftoj anëtarët prezent në mbledhje nëse kanë diskutime për sa u parashtrua nga relatorja.

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

***Irena Plaku:*** Pro.



***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Ilir Rusi***: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017-2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 15 e rendit të ditës)

## **Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 16 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}, (relatore znj. Irena Plaku).<sup>7</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikëna Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>7</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 14-ta sipas rendit të ditës.

*Shënim:* Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

*1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

*2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

*3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

*4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*

*5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*

*6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

#### **RENDI I DITËS:**

16. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}, (relatore znj. Irena Plaku).

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej fjalën relatores, zonjës Plaku.

*Irena Plaku:* Faleminderit!

Atëherë, po ju paraqes në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit për periudhën e gradimit për gjyqtarin {...}, duke qenë se jeni njohur të gjithë me projektraportin e vlerësimit në mënyrë të detajuar.

Vlerësimi për gjyqtarin {...} ka filluar me vendimin nr. 239/2022 të KLGJ-së, pasi është dërguar nga organet e rivlerësimit dosja e tij.

Gjithashtu janë kryer të gjitha procedurat për administrimin e akteve të burimeve të vlerësimit me vendimin e datës 13.03.2023 nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale pasi gjeti të plotë dokumentacionin, vendosi vijimin e procedurës për hartimin e projektraportit.

Duke qenë se burimet e vlerësimit janë të detajuara në projektraport, do kaloj direkt tek katër kriteret e vlerësimit. Konkretisht kriteri i parë “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, nëntreguesi Njohuritë ligjore, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, referuar burimeve të vlerësimit, në tërësi rezulton aftësia e gjyqtarit për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, konkretisht për llojin e gjykimit të proceduar në çështjet penale, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen në trajtimin e kërkesave, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor. Po ashtu rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet civile dhe çështjet penale. Evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore vetëm të Gjykatës së Lartë në lidhje me pranimin e kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar, si dhe kujdesi maksimal për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime

të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit 1.b.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Mënyra e zgjedhjes, përdorimi i fjalëve dhe organizimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të shprehurit me gjuhë të thjeshtë dhe koncize, i bën vendimet të qarta dhe të kuptueshme. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalim nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra në mënyrë logjike, ku dalin qartë dhe konkluzionet e gjykatës, të cilat vijnë si rrjedhë logjike e të gjithë arsyetimit të vendimit.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve, duke e gërshetuar me provat e lejuara për shqyrtim, identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtari ka një metodologji të tij të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke i ndarë me paragrafë, të cilat vijnë në rrjedhë kronologjike dhe logjike midis njëri-tjetrit, megjithëse nuk i ndanë vendimet në nënpjesë me fjali përshkruese, nga përbërja e tyre identifikohet qartë secila pjesë vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese – arsyetuese (e ndarë në paragrafë, të cilët vijnë njëri pas tjetrit, duke filluar me rrethanat e faktet e provuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pretendimet e palëve, pasqyrimin e ligjit të zbatueshëm dhe në analizën juridike), si dhe dispozitivin.

Referuar sa më sipër, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në ndjekjen e një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin e përmbajtjes, por jo vizual, por duke i dhënë qëndrueshmëri dhe

kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit lidhur me këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik. Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi të lartë në këtë tregues. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit edhe pse nuk i është referuar shumë qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa më sipër, propozimi për kriterin “Aftësia profesionale e gjyqtarit”, është 100 pikë.

Në lidhje me kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, konkretisht Respektimi i afateve ligjore. Si burim vlerësimi për këtë tregues ka shërbyer raporti për analizimin e aftësive profesionale i hartuar nga KLGJ-ja për efekt të Komisionit të Posaçëm të Vlerësimit si dhe 6 dosjet e hedhura me short pas procedurës së vlerësimit.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes.

Konkretisht, rezulton se për një çështje të ketë përfunduar për një afat prej 13 ditësh, brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 610 i KPRC; sa i përket kërkesës penale rezulton të ketë përfunduar për një afat prej 2 ditësh. Sa më sipër rezulton se të dyja çështjet kanë përfunduar brenda afatit ligjor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes në zhvillimin e gjykimit brenda afateve

ligjore, në çështjet e analizuar për të cilën ligji ka parashikuar afat ligjor, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarit është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor rezulton në nivelin 0-10 %.

Sa i përket 2.A.b Plotësimi të standardeve minimale kohore, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet për 9 (nëntë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari. Nuk përfshihen çështjet për të cilën parashikohen në ligj afate gjykim, konkretisht çështja e përfunduar me vendimi nr. 850, datë 22.06.2015. Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se në çështjet e vëzhguara, gjykimi përgjithësisht ka përfunduar brenda standardeve minimale të parashikuara në vendimin nr.261/2 të ish-KLD-së.

Në projektraport janë analizuar afatet e gjykimit të secilës çështje më vete.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 12 (dymbëdhjetë) çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas vendimit të ish-KLD-së, pasi 2 (dy) prej tyre kanë përfunduar tej afatit ligjor. Në total 16.7 % të çështjeve janë tej afatit standard minimal kohor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, 83.3 % të çështjeve të analizuara kanë përfunduar brenda afatit ligjor. Referuar metodologjisë së pikëzimit, kjo përqindje pikëzohet me 4 (katër) pikë. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike.

Në kontekst të sa më sipër u analizua kompleksiteti i çështjeve, i përcaktuar në metodologji si një nga komponentët që mund të çojë në një pikëzim më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore nga e cila rezultoi se dy çështjet të cilat janë gjykuar jashtë standardit minimal, janë dy vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, të cilat janë çështje penale për veprat penale të kategorisë krime. Referuar përmbajtjes së vendimit, në



kushtet kur nuk ka të dhëna të tjera, rezulton së për këto dy çështje gjykimi ka vijuar me procedurën e gjykimit të zakonshëm, gjatë secilës janë administruar edhe provat me dëshmitarë. Nuk konstatohet ndonjë arsye tjetër që mund të ketë ndikuar në afatin e përfundimit të gjykimit pasi siç e thashë janë dy vendime të zgjedhura nga ana e gjyqtarit dhe nuk janë administruar dosjet.

Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve, gjyqtari ka përfunduar në total për 3 vite periudhë vlerësimi, konkretisht nga muaji tetor 2013-tetor 2016, 1096 çështje, nga të cilat 253 çështje penale themeli, 205 kërkesa penale, 171 civil themeli, 140 çështje familjare dhe 327 kërkesa civile. Pra gjithsej gjatë kësaj periudhe ka përfunduar 253 çështje penale themeli dhe 311 çështje civile me palë kundërshtare, dhe 532 kërkesa penale dhe civile, duke gjykuar mesatarisht 188 çështje në vit.

Sipas të dhënave statistikore si dhe informacionit të marrë nga burimet njerëzore të KLGJ-së, rezultoi se me vendimin nr.264, datë 02.06.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ai është deleguar për të ushtruar detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datë 23.07.2014, pra për një periudhë rreth 9 muaj, gjatë periudhës së vlerësimit, apo për rreth gati 6 muaj gjatë vitit 2014. Gjithashtu, për periudhën 2013-2015 ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në seksionin penal, dhe nga data 05.01.2015-30.12.2016 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në seksionin civil.

Referuar përcaktimeve të aspektit sasior, të përcaktuar në vendimin nr.261/2, ku gjyqtari në çështjet civile duhet të shqyrtojë jo më pak se 120 çështje ndërsa në seksionin penal 100 çështje, ndërsa në pikën 3, shkronja “k” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit është përcaktuar se Kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese minimale respektivisht në masën e 40 %.

Sa më sipër, po t'i referohesh të dhënave statistikore rezulton se gjyqtari ka tejkaluar çdo vit standardin minimal sasior të ngarkesës së tij në punë.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

(i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuara si më sipër cituar, që rezulton në masën 16.7%, përqindje që sipas metodologjisë, pikëzohet me 4 pikë;

(ii) faktorët që mund të kenë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit;

(iii) tejkalimi i standardit sasior për çdo vit nga gjyqtari, duke e tejkaluar atë me 143 % dhe në dy vitet e tjera me më shumë se 50 %;

vlerësoj se për këtë tregues duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë.

Sa më sipër propozohet vlerësimi i tij me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 15 % të çështjeve jashtë standardit minimal, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

2.a.c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, edhe për këtë tregues, vlerësimi do bëhet vetëm mbi dosjet të cilat janë përzgjedhur me short dhe të përzgjedhura nga gjyqtari.

Referuar kategorive të çështjeve (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 8 (tetë) çështjet në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë 166.5 ditë, ose 5 muaj e 16 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj. (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështjet “Civile themeli”, është 96 ditë, ose 3 muaj e 6 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muajsh. (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Familjare”, është 107 ditë, ose 3 muaj e 17 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal.

Referuar sa më sipër, duke qenë se të gjitha çështjet janë shqyrtuar mesatarisht brenda standardit minimal, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë dhe propozohet pikëzimi i tij me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve, referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit rezulton se rendimenti i tij është llogaritur me 94.6 %. Megjithatë janë marrë dhe janë vlerësuar edhe një herë të dhënat statistikore referuar vërtetimeve të ndodhura në dosje, për të cilën është bërë edhe shorti për përzgjedhjen e tyre.

Referuar të dhënave statistikore, për periudhën 08.10.2013-08.10.2016, ka rezultuar se për vitin 2013 (08.10.2013-31.12.2013), ka përfunduar 28 çështje. Për vitin 2014 ka përfunduar 209 çështje. Për vitin 2015 ka përfunduar 485 çështje. Për vitin 2016 ka përfunduar 374 çështje.

Nga llogaritja e numrit të çështjeve të caktuara me numrin e çështjeve të

përfunduara me vendim, rezulton se rendimenti ka rezultuar 96.5%. Referuar metodologjisë, kjo pikëzohet me 8 pikë.

Megjithatë, referuar metodologjisë përcaktohet se: “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur situata të cilat nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, pasur parasysh ngarkesën e gjyqtarit ku për periudhën 2013 deri në janar të 2015 gjyqtari ka ushtruar funksionin në seksionin penal, dhe nga data 05.01.2015-30.12.2016 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në seksionin civil. Gjithashtu, për një periudhë gjashtëmujore ka ushtruar edhe detyrën e kryetarit të gjykatës.

Për vitin 2014, kur gjyqtari ka punuar në seksionin penal si dhe ka kryer për gati gjysmën e vitit dhe funksionin e kryetarit të gjykatës, çka nënkupton një ngarkesë sasiore gjatë vitit prej jo më pak se 70 çështje penale themeli, rezulton se ka përfunduar 170 çështje penale themeli, duke tejkalluar kështu standardin sasior gjatë këtij viti me 100 çështje apo me rreth 143%. Ndërsa për periudhën, 2015-2016 rezultoi se gjyqtari ka punuar në seksionin civil të përgjithshëm, duke gjykuar edhe çështje familjare, çka nënkupton një ngarkesë sasiore për një vit prej 120 çështje me palë kundërshtare. Nga të dhënat statistikore rezultoi se gjatë vitit 2015, gjyqtari ka përfunduar 44 çështje penale themeli, 96 çështje civile të përgjithshme dhe 65 çështje familjare, pra gjithsej 205 çështje, duke qenë mbi standardin sasior me 85 çështje. Për vitin 2016, e cila përfshin një periudhë thujse 9 muaj, ka përfunduar 11 çështje penale themeli, 75 çështje civile, 41 çështje familjare dhe 20 urdhra mbrojtjeje, pra 147 çështje me palë kundërshtare, ndërkohë duhet të përfundonte rreth 90 çështje për këtë periudhë, duke qenë mbi standardin minimal sasior me 57 çështje.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarit rezulton me 96.5%, përqindje e cila pikëzohet me 8 pikë, pasur parasysh faktin se gjyqtari ka tejkalluar në çdo vit standardin minimal të miratuar mbi 50 %, ku për vitin 2014 (i cili është vit i plotë i vlerësimit ) e ka tejkalluar me 147 %, numrin e lartë të kërkesave të shqyrtuara gjatë periudhës së vlerësimit prej 532 kërkesa, të cilat rrisin dukshëm ngarkesën e gjyqtarit (pasur parasysh se disa kanë qenë edhe me afat ligjor, p.sh. urdhrat e ekzekutimit, apo masat e sigurimit personal), faktin se për një periudhë ai ka ushtruar edhe funksionin e kryetarit të gjykatës, vlerësohet se mund të arrihet në një pikëzim më të lartë se ai që i përket rendimentit, duke u pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit. Edhe për këtë tregues vlerësimi është bërë mbi dosjet e përzgjedhura për shkak se të dhënat statistikore nuk mundësojnë të dhëna të tilla. Referuar 11 dosjeve të përzgjedhura me short rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit për çështjet penale është 2.8 ditë; për kategorinë “Civile” është 3.25 ditë; për kategorinë e çështjeve “Familjare” është 1 ditë dhe për kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale” është 3 ditë, pra është “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”. Për sa më sipër propozohet vlerësimi i tij me 15 pikë.

Sa i përket treguesit 2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Edhe për këtë tregues, vlerësimi është bërë për 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim. Lidhur me numrin e seancave, vetëm 10 prej tyre vlerësohet si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional pasi dosja nr. 5 i përket kategorisë “kërkesa penale”.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, konkretisht të 10 (dhjetë) dosjeve të administruara, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare, varion nga 1-10 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 4.5 seanca në çështjet civile me palë kundërshtare (duke përjashtuar seancat përgatitore), 4.4 seanca në çështje penale themeli dhe 3 seanca gjyqësore në një çështje familjare (duke përjashtuar seanca e pajtimit). Në total numri mesatar i seancave është 4.3 seanca.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil, penal dhe familjar. Në çështjet penale data e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10-ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale. Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimi i palëve, dhënien e kohës së palëve për të paraqitur prova, prapësimet dhe pretendimet e fundit, mosparaqitjen e prokurorit, të mbrojtësve apo

përfaqësuesve të palëve, njoftimin e ekspertit, dhënien e kohës së ekspertit për të kryer aktin, etj.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “Numrit mesatar të seancave gjyqësore” duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar është 4.3 seanca, por nga ana tjetër gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave është 4.3 seanca (më i lartë se 3), shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive është e lartë, prandaj vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë. Sa më sipër vlerësoj në lidhje me këtë tregues se aftësia e gjyqtarit është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit. Edhe për këtë tregues, nga analiza e burimeve të vlerësimit, konkretisht nga 11 çështjet e përzgjedhura me short, 10 (dhjetë) prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare dhe 1 (një) çështje i përket kategorisë së kërkesave penale, gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose deri në 9 ditë. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, në përgjithësi mbajtur me regjistrim audio, si dhe dokumentohen me shkrim. Janë respektuar dispozitat procedurale për zhvillimin e seancave.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtari në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil dhe penal, në seancat përgatitore dhe gjyqësore.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e tij është e lartë duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore, konkretisht 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues pasi renditja e dosjeve në çështjet penale fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar. Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, aktet e njoftimit të palëve, vendimin e gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, procesverbalet e seancave përgatitore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Referuar sa më sipër vlerësoj se për këtë tregues aftësia e tij është shumë e lartë duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit. Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara dhe nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve të cilat nuk i përkasin dosjeve.

Sa më sipër aftësia e tij rezulton shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimit për kriterin e dytë “Aftësia organizative” është “Shkëlqyeshëm”, 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, Etika në punë, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë. Për këto arsye, aftësia e tij vlerësohet shumë të lartë duke e pikëzuar me 35 pikë.

Integriteti i gjyqtarit – Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari gëzon integritet, për këtë arsye aftësia e tij vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 40 pikë.

Paanësinë e gjyqtarit, 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë dhe për këtë arsye propozohet pikëzimi i tij me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtim, nga 5 dosjet e vëzhguara për gjyqtarin të cilat janë administruar në procesin e rivlerësimit, nuk rezulton asnjë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit dhe dosjet e përzgjedhura nuk rezulton se ndaj gjyqtarit të jetë paraqitur ndonjë kërkesë për përjashtimin e tij (*ripërsëritje*). Për këtë arsye rezulton se numri është i pakonsiderueshëm dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë "Shkëlqyeshëm".

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, 4.A Aftësia e komunikimit.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me palët pjesëmarrëse në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Sa më sipër, lidhur me këtë tregues, aftësia e tij vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Sa më sipër për këtë tregues vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë

4.B Aftësia për të bashkëpunuar, shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe me administratën. Për të dy treguesit aftësia është shumë e lartë duke e pikëzuar me 15 dhe 10 pikë, pasi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që reflekton për sa i përket shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me gjyqtarët apo edhe me administratën.

4.C Gatishmërinë e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, 4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit ka marrë pjesë në 17 aktivitete të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës, gjithsej me 29 ditë.

Gjithashtu ka marrë pjesë në një trajnim jashtë Shkollës së Magjistraturës, ku një trajnim është jashtë periudhës së vlerësimit pasi është viti 2012. Megjithatë referuar numrit të trajnimeve (ditëve) të realizuara pranë Shkollës së Magjistraturës e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë, vlerësohet se aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve. Nuk rezulton asnjë e dhënë për këtë tregues. Sa më sipër, duke qenë se pjesëmarrja në këtë veprimtari jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin me 3 pikë. Për këtë arsye propozimi për këtë tregues është 3 pikë.

4.C.c Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun, referuar burimeve të vlerësimit, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtari lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit nuk është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë, siç janë fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit, etj.

Bazuar në sa më sipër është propozuar pikëzimi i tij me 3 pikë, duke qenë se vlerësimi për këtë tregues fillon me 3 pikë dhe shtohen 2 pikë në rast të vërtetimit të angazhimit.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari fillimisht nuk ka paraqitur kundërshtime, më pas ka paraqitur kundërshtime duke kërkuar që të pikëzohet me 5 pikë, pasi ka pretenduar se gjatë periudhës së vlerësimit, konkretisht në vitin 2013 ai është angazhuar në mësimdhënien pranë Universitetin "Kristal", por se nuk ka një vërtetim për të paraqitur, duke qenë se shkolla është mbyllur. Por ka referuar se të dhënat e lidhura me angazhimin e tij rezultojnë tek vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.



Referuar vendimit të KPK-së, nr.520, datë 30.03.2022, konkretisht në faqen 8 të tij, është përcaktuar se gjyqtari ka të dhëna që ka marrë pagesa nga universiteti “Kristal” që i përkasin periudhës 2011-2012 dhe 2013, por referuar të dhënave rezulton se pagesën e fundit për punën e kryer rezulton të jetë më datë 08.11.2013, rreth një muaj pasi ka filluar periudha e vlerësimit.

Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, unë nuk propozoj se jemi në kushtet e rritjes së pikëve, pasi këto të dhëna nuk tregojnë periudhën gjatë së cilës ai ka bërë mësimdhënie pranë Univerisitetit “Kristal” por vetëm provon se në periudhën e vlerësimit, konkretisht brenda 1 muaji nga periudha e vlerësimit, ka marrë një pagesë.

Për sa më sipër, unë i qëndroj propozimit për pikëzimin e tij me 3 pikë edhe për këtë tregues.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna për këtë tregues. Për sa më sipër propozohet pikëzimi i tij me 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit të “Aftësive personale dhe angazhimi profesional”, është 91 pikë, vlerësimi "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi është si më poshtë:

Aftësitë profesionale, 100 pikë.

Aftësitë organizative, 100 pikë.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë.

Niveli i përgjithshëm i pikëzimit 391. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Plaku!

Ftoj anëtarët prezent në mbledhje nëse kanë diskutime për sa u relatua.

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 16 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.07.2023)*

**Pika 17 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>8</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:15 dhe mbaroi në orën 13:38.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>8</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje. Sipas rendit të ditë kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 16-ta.

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**

**5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

#### **RENDI I DITËS:**

17. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e fundit për mbledhjen e datës 13 korrik lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme. Fjala i jepet relatorit të kësaj çështjeje për të relatuar relacionin e përgatitur nga Komisioni si më poshtë.

Relatohet nga zoti Kurushi se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat ka bërë një kërkesë për një çështje penale dhe kërkohet një gjyqtar (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion). Kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues në çështjen me te pandehur {...}. Trupi

108

grykues përbëhet nga gryqtarët {...} dhe {...}. Gryqtare {...}, {...} dhe {...} kanë grykuar të bashkëpandehurit dhe janë shprehur me vendimin nr.102, datë 15.03.2023. Gryqtari z. Zaimi ka grykuar kërkesën për caktim mase sigurimi.

Për nevojat si më lart të Grykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gryqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gryqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gryqtarit për grykimin e një çështje gryqësore të veçantë, në një grykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Grykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gryqtari që do të caktohet për grykimin e 1 (një) çështjeje gryqësore të veçantë penale, të jetë Grykata e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, seksioni penal.

Numri i gryqtarëve që duhet të caktohen për grykimin e 1 (një) çështje gryqësore të veçantë penale të jetë 1 (një).

Lidhur me përjashtimet nga shorti, Komisioni propozon:

Të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e grykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, konkretisht: znj. Olkeda Lice.

Gjithashtu, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që të përjashtohet nga shorti znj. {...}, pasi Këshilli me vendimin nr. 323 datë 14.06.2023 ka vendosur: “Komandimin e gryqtares znj. {...} në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Grykatës së Lartë. 2. Afati i komandimit është 5 (pesë) vjet dhe fillon më datë 15.07.2023”.

*Pas relatimit, anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gryqtarja Miranda Nakaj.

Mbyllen procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**